



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 dhjetor 2021
Nr. ref.: RK 1911/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI115/20

Parashtrues

Muharem Rama

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. A. (U) nr. 5/2020, të 6 majit
2020 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 918/2019],
të 6 janarit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muharem Rama nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. A. (U) nr. 5/2020] të 6 majit 2020 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 918/2019] të 6 janarit 2020.
3. Parashtruesi i kërkesës, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 918/2019] të 6 janarit 2020, e ka pranuar më 29 janar 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 5 [Gjuhët] 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 59 [Llojet e vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 gusht 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues) Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
8. Më 12 gusht 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 9 shkurt 2021, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), dorëzimin e dosjes së plotë të lëndës.
10. Më 12 shkurt 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.
11. Më 2 mars 2021, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë informata shtesë.
12. Më 5 mars 2021, Gjykata i dërgoi një kërkesë për informata shtesë Gjykatës Themelore.

13. Më 9 mars 2021, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë informata shtesë.
14. Më 14 maj 2021, Gjykata dërgoi një shkresë dhe kërkoi informata shtesë nga Gjykata Themelore dhe Supreme.
15. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
16. Më 19 përkatësisht 25 maj 2021, Gjykata Supreme dhe ajo Themelore dorëzuan në Gjykatë informata shtesë.
17. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
18. Më 3 nëntor 2021, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 26 korrik 2019, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës – Inspektorati Farmaceutik (në tekstin e mëtejme: Inspektorati Farmaceutik) përmes vendimit [Nr. 10/AI-014-19] ndëshkoi me gjobë prej 1000 (një mijë euro) parashtruesin e kërkesës, dhe urdhëroi që gjoba të paguhet në afat prej 8 (tetë) ditësh, për shkak se gjatë inspektimit në barnatoren qendrore të spitalit të përgjithshëm të Prizrenit, ka konstatuar se Muharem Rama në detyrën e farmacistit përgjegjës të spitalit të përgjithshëm në Prizren, ka pranuar dhe shpërndarë produkte medicinale pa banderola të Ministrisë së Shëndetësisë.
20. Më 13 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë pranë Ministrisë së Shëndetësisë – Inspektoratit Shëndetësor (në tekstin e mëtejme: Inspektorati Shëndetësor) kundër vendimit të Inspektoratit Farmaceutik.
21. Më 10 shtator 2019, Inspektorati Shëndetësor përmes Vendimit [Nr.10/K-22-19] refuzoi si të pabazë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe la në fuqi vendimin e Inspektoratit Farmaceutik.
22. Më 10 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi pranë Gjykatës Themelore kundër Vendimit [Nr. 10/K-22-19] të 10 shtatorit 2019 të Inspektoratit Shëndetësor, dhe i propozoi Gjykatës që të shtyjë ekzekutimin e vendimit të lartcekur.

23. Më 19 nëntor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 2409/19] refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të Inspektoratit Shëndetësor.
24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë pranë Gjykatës së Apelit kundër Aktvendimit [A. nr. 2409/19] të 19 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore.
25. Më 6 janar 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [A. A. nr. 918/2019], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [A. nr. 2409/19] e 19 nëntorit 2019 të Gjykatës Themelore.
26. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës dhe të drejtës materiale, me propozimin që të miratohet kërkesa për revizion.
27. Më 6 maj 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. A (U) nr. 5/2020], hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit.
28. Gjykata Supreme në aktvendimin e saj, ndër të tjera, theksoi: *“Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo Gjykatë gjen se kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrrojë Gjykatës Supreme kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshem të vendimit gjyqësor dhe prokurori publik mund t'i parashtrrojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, që do të thotë kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë s'mund të paraqitet revizioni, andaj kjo Gjykatë revizionin e paditësit e hodhi poshtë si të palejuar”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. A (U) nr. 5/2020] e 6 majit 2020 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 5 [Gjuhët], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
30. Pretendimet kryesore parashtruesi i kërkesës i ndërlidh me shkeljen e neneve të lartcekura të Kushtetutës, duke potencuar me theks të veçantë shkeljen e nenit 5 të Kushtetutës, ku ai pretendon se gjykatat e rregullta, pra ajo Themelore dhe Supreme nuk e kanë njoftuar në gjuhën në të cilën ai i ka parashtruar parashtruesat.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktvendimit të Gjykatës Supreme atij i *“janë shkelur parimet e shprehura me nenin 5 të Kushtetutës, me marrjen e papritur dhe të paarsyetuar të akteve të cilat nuk janë në gjuhën në të cilën janë parashtruar parashtruesat. Kjo pastaj më ka anashkaluar nga Gjykata Themelore për çështje administrative dhe nga Gjykata Supreme. Nga gjyqtarët e Gjykatës Supreme kanë kontribuar në zbatimin e pabazuar të nenit 24 Barazia para ligjit dhe nenit 31 E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm,*

dhe janë shkelur parimet e shprehura në Kushtetutë nga neni 5 Gjuhët, të cilat janë parashikuar edhe në rregulloret tjera të Republikës së Kosovës duke filluar nga Ligji për përdorimin e gjuhës”.

32. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se Gjykata Supreme nuk e ka parë dhe identifikuar nevojën e përcaktimit kushtetues mbi gjuhët, kur nuk e ka zbatuar këtë dispozitë kushtetuese mbi gjuhët e që ka rënduar punën e grupit të ekspertëve të cilët kanë marrë pjesë në hartimin e parashtresave. Ai më tej thekson se përveç vendimit të Gjykatës së Apelit të cilin e ka marrë në *“gjuhën e parashtresave”*, vendimet e Gjykatës Themelore dhe Supreme nuk i ka marrë në të njëjtën gjuhë.
33. Sa i përket pretendimit për shkelje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme *“nuk i ka kushtuar vëmendje zbatimit të nenit 5, nenit 24 dhe 31, për çka as nuk ka mundur që procedura të zhvillohet në nivelin e parimit të drejtësisë e me këtë është pamundësuar njohja e temave profesionale e që është mangësi e rëndësishme”*. Lidhur me këto pretendime, ai më shumë nuk sqaron si dhe pse ka ardhur deri te këto shkelje të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI Nr. 03/L-202 PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE

Neni 24

1. Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund t'i parashtojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Neni 25

1. Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm.

[...]

Neni 50

1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
35. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], dhe 48 [Saktësimi i kërkesës], të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. A (U) nr. 5/2020], të 6 majit 2020, pasi i ka shteruar mjetet juridike të parapara me ligj.
38. Megjithatë, Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafin (1) (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

Rregulli 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”

39. Në lidhje me sa u tha më sipër, Gjykata rikujton se afati 4 (katër) mujor fillon nga *“vendimi i fundit”* në procesin e shterjes së mjeteve juridike me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesit (shih *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI120/17, parashtrues: *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 30; si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, Vendim i 14 marsit 2002).
40. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesi i kërkesës duhet t’i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi i kërkesës nuk mund të zgjasë afatet kohore strikte të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike që nuk janë të lejuara ose duke u ankuar në institucionet të cilat nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI120/17, parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 31; KI112/19, parashtrues *Ilir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 38; si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006).
41. Gjykata vëren se procedura ndaj parashtruesit të kërkesës e zhvilluar para gjykatave të rregullta në lidhje me kërkesën e tij për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të Inspektoratit Shëndetësor, kishte përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 918/2019] të 6 janarit 2020, përmes së cilit ishte refuzuar ankesa kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore.
42. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës dhe të së drejtës materiale.
43. Sa i përket këtij vendimi të Gjykatës Supreme i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se në Aktvendimin [Rev. A. (U) nr. 5/2020] të 6 majit 2020, Gjykata Supreme nuk është marrë me pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit, por ekskluzivisht me çështjen e natyrës procedurale në lidhje me

llojin e mjetit juridik i cili është paraqitur nga parashtruesi në Gjykatën Supreme.

44. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte konstatuar se në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore të Ligjit për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejme: LKA), në nenin 24.1 dhe nenin 25.1 është rregulluar ekzistimi i dy kategorive të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, të cilat palët e pakënaqura mund t'i paraqesin në Gjykatën Supreme në lidhje me vendimin e formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë për çështje administrative.

45. Në kategorinë e parë gjendet kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, siç parashihet me nenin 24, paragrafin 1 të LKA-së, i cili, *inter alia*, thotë:

“Neni 24.1. Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund t'i parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor”.

46. Në kategorinë e dytë gjendet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, siç parashihet me nenin 25.1 të LKA-së, i cili, *inter alia*, thotë:

“Neni 25.1. Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm”.

47. Në lidhje këtë, Gjykata i referohet Aktvendimit [Rev. A (U) nr. 5/2020], të Gjykatës Supreme, që hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se: *“Kjo Gjykatë gjen se kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund t'i parashtrojë Gjykatës Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe prokurori publik mund të parashtrojë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, që do të thotë kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë s'mund të paraqitet revizion, andaj kjo Gjykatë revizionin e paditësit e hodhi poshtë si të palejuar”.*

48. Në bazë të kësaj, Gjykata vëren se në pajtim me Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. A (U) nr. 5/2020], parashtruesit e kërkesës nuk e kanë paraqitur formën e duhur të mjetit juridik në Gjykatën Supreme, e cila në këtë rast do të ishte kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, por kanë paraqitur kërkesën për revizion, që nuk është në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore të LKA-së (neni 24, paragrafi 1 dhe neni 25, paragrafi 1).

49. Prandaj, Gjykata gjen se për shkak të vetë faktit se parashtruesi i kërkesës nuk e vazhdoi procedurën gjyqësore me mjetin juridik i cili ka qenë në dispozicion në çdo kohë, ai i ka kontribuar faktit se Gjykata Supreme nuk ka mundur të vazhdojë me vërtetimin e bazueshmërisë së pretendimeve të tij ankimore (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI76/17, parashtrues *Nysret Fana* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 prillit 2018, paragrafi 57).

50. Për më tepër, Gjykata rikujton se, në rastin e parashtruesit të kërkesës, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 918/2019] të 6 janarit 2020, asgjë nuk e ka ndaluar atë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ai ka përdorur mjete juridike, si revizionin kundër Aktvendimit [A. A. nr. 918/2019] të Gjykatës së Apelit, i cili nuk kanë qenë i paraparë me ligj.
51. Rrjedhimisht, si “vendim i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 918/2019], i 6 janarit 2020, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, dhe i cili ishte përfundimtar dhe i paapelueshëm (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI112/19, parashtrues *Ilir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 43; KI23/19, parashtrues *Agim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 tetorit 2021, paragrafi 93).
52. Andaj, Gjykata rikujton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 918/2019], ishte nxjerrë më 6 janar 2020. Në bazë të fletkthesës e cila ndodhet në dosjen e rastit shihet që parashtruesi i kërkesës, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit e ka pranuar më 29 janar 2020, dhe me këtë Gjykata vëren se koha në mes të pranimit të aktvendimit dhe të datës së dorëzimit të kërkesës së tij, më 22 korrik 2020, në Gjykatë ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh.
53. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 918/2019] të 6 janarit 2020, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
54. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë kohore e palëve dhe personave të tjerë të përfshirë në procese gjyqësore (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesat nr. (10865/09, 45886/07 dhe 32431/08), të 17 shtatorit 2014, paragrafi 258; shih, gjithashtu Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë*, nr. 56080/13, të 19 dhjetorit 2017, paragrafi 129; dhe, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI112/19, parashtrues *Ilir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 46).
55. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial të kërkesës që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqesë kërkesë dhe, nëse dëshiron, të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur dhe në të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve në këtë rast, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, të 29 qershorit 2012, paragrafi 39; shih po ashtu edhe rastin e Gjykatës KI12/20, parashtruese e kërkesës *Hamijete Dinarama-Daija*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2020, paragrafi 42).
56. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli

i tillë nuk është më i mundur (shih Vendimin e GJEDNJ-së *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, të 25 janarit 2000; shih, gjithashtu, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë*, të cituar më lart, paragrafi 40; shih po ashtu edhe rastin e Gjykatës KI53/18, parashtrues i kërkesës *Hajri Ramadani*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2018, paragrafi 45).

57. Andaj, mbi bazën e arsyetimeve të mësipërme, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 3 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Selvetë Gërxhalin-Krasniqi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani